

URDHËR
Nr. 274, datë 5.5.2023

**PËR PROCEDURËN, KUSHTET DHE KRITERET QË DUHET TË PLOTËSOJË
NJË OPERATOR PËR T’U MIRATUAR PËR LËSHIMIN E PASAPORTËS BIMORE,
SI DHE RASTET E HEQJES SË MIRATIMIT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, pikës 5, të nenit 12, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

I. Të përgjithshme

1. Operatori profesionist që kërkon të miratohet për lëshimin e pasaportës bimore duhet të jetë i regjistruar sipas nenit 6/1, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

2. Pasaporta bimore lëshohet vetëm për bimë, produkte bimore dhe objekte të tjera për të cilat është kryer një ekzaminim i kujdesshëm. Bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera mund të ekzaminohen individualisht ose me mostra përfaqësuese. Ekzaminimi përfshin, gjithashtu, materialin e paketimit të bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera të përfshira.

II. Aplikimi, kushtet dhe kriteret që duhet të plotësojnë operatorët profesionistë për t’u miratuar për lëshimin e pasaportës bimore

Operatori profesionist, i cili kërkon të miratohet për lëshimin e pasaportës bimore për bimët, produktet bimore dhe objekte të tjera, paraqet pranë Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) kërkesën për miratim për lëshimin e pasaportës bimore sipas formatit të paraqitur në shtojcën 1 të këtij urdhri.

Operatori profesionist, i cili ka kërkuar të miratohet për lëshimin e pasaportës bimore, për plotësimin e kërkesave të paragrafit të dytë, i provon AKVMB-së se zotëron kompetencë për lëshimin e pasaportës bimore. Kjo kompetencë duhet të provohet nga përfundimi me sukses i një kursi trajnimi nga operatori profesionist, si dhe gjatë inspektimit në vend të kryer nga AKVMB-ja.

Operatori profesionist që kërkon të miratohet për lëshimin e pasaportës bimore duhet të plotësojë kushtet dhe kërkesat e mëposhtme:

1. Të zotërojë njohuritë e nevojshme për zbatimin e rregullave që lidhen me ekzaminimet e dëmtuesve karantinorë, dëmtuesve karantinorë të zonës së mbrojtur dhe dëmtuesve jokarantinorë të rregulluar, që mund të prekin bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera. Këto rregulla përfshijnë:

a) kryerjen e ekzaminimeve në kohë të përshtatshme dhe duke marrë parasysh rreziqet e përfshira;

b) kryerjen e ekzaminimeve në ambiente të përshtatshme të izoluar për të penguar përhapjen dhe, në raste të caktuara, kryerjen e ekzaminimit në afërsi të vendit të prodhimit të bimëve, produkteve bimore ose objekteve të tjera;

c) kryerjen të paktën të ekzaminimit vizual, të plotësuar nga:

i. inspektimet, marrja e mostrave dhe testimi nga AKVMB-ja në rast dyshimi për praninë e një dëmtuesi ose dëmtuesi karantinor që u nënshtrohet masave të miratuara në legjislacionin në fuqi ose në rast të dyshimit për praninë e një dëmtuesi karantinor të zonës së mbrojtur në zonën e mbrojtur përkatëse; ose

ii. marrja e mostrave dhe testimi në rast dyshimi për praninë e një dëmtuesi jokarantinor të rregulluar;

ç) regjistrimin dhe ruajtjen për të paktën tre vjet të rezultateve të ekzaminimit.

2. Ka njohuritë e nevojshme për praktikat më të mira, masat dhe veprime të tjera të nevojshme që duhet të ndërmerren për të parandaluar praninë dhe përhapjen e dëmtuesve të përmendur në pikën 1 të këtij kreu.

3. Ka një plan efektiv, i cili do të ndiqet në rast të ndonjë dyshimi të shfaqur ose gjetje të dëmtuesve që prek ose që mund të prekë bimët, produktet bimore ose objektet e tjera.

4. Ka njohuri dhe kompetencën e nevojshme për kryerjen e ekzaminimeve të kërkuara për bimët, produktet bimore ose objekte të tjera për dëmtuesit përkatës dhe të marrë masat e përmendura në pikën 2 të këtij kreu.

5. Posedon ose ka akses në pajisjet dhe objektet e nevojshme për kryerjen e ekzaminimeve të kërkuara në bimë, produkt bimor ose objekte të tjera, si dhe ka aftësinë për të marrë masat e përmendura në pikën 2 të këtij kreu.

6. Ka caktuar një person përgjegjës për komunikimet me AKVMB-në, në lidhje me këtë procedurë dhe i ka njoftuar AKVMB-së personin përgjegjës dhe të dhënat që garantojnë komunikimin.

7. Ka sisteme dhe procedura që i mundësojnë të përmbushë detyrimet e ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, në lidhje me gjurmueshmërinë. Kodi i gjurmueshmërisë nuk kërkohet kur bimët për mbjellje janë përgatitur në mënyrë të tillë që të jenë gati për shitje të përdoruesit e fundit pa ndonjë përgatitje të mëtejshme dhe nuk ekziston asnjë rrezik në lidhje me përhapjen e dëmtuesve ose dëmtuesve karantinorë.

Përfundim nga kërkesa e kodit të gjurmueshmërisë për pasaportat bimore për lëvizje brenda territorit të vendit nuk zbatohet për llojet dhe llojet e bimëve për mbjellje të listuara në shtojcën III të këtij urdhri.

8. Ka kaluar me sukses testimin e organizuar nga AKVMB-ja nëpërmjet drejtorive rajonale.

III. Procedurat që garantojnë përmbushjen e kriterëve nga operatorët profesionistë që kërkojnë të miratohen për lëshimin e pasaportës bimore

1. AKVMB-ja, bazuar në kërkesat e ardhura, organizon kurse trajnimi për operatorët profesionistë, si dhe u garanton atyre që të kenë akses në udhëzuesin mbi kriteret që duhet të plotësohen në testimin, në lidhje me lëshimin e pasaportave bimore. Ky udhëzues të jetë i aksesueshëm përmes faqes zyrtare të internetit të MBZHR-së dhe AKVMB-së, të përgatitet nga AKVMB-ja dhe të përmbajë të gjitha elementet e mëposhtme:

a) informacion rreth biologjisë së dëmtuesve dhe vektorëve përkatës, dhe aspektet e lidhura me biologjinë e bimëve bujtëse;

b) informacion në lidhje me shenjat e pranisë së dëmtuesve dhe simptomat e infektimit të bimëve, produkteve bimore apo objekteve të tjera nga dëmtuesit përkatës, mënyrën e kryerjes së inspektimeve vizuale, si dhe marrjen e mostrave dhe testimin;

c) informacion në lidhje me praktikën më të mira, masat dhe veprimet e tjera që duhen të ndërmerren për të parandaluar praninë dhe përhapjen e dëmtuesit të përmendur në pikën 2, të kreut II;

ç) informacion mbi krijimin dhe përmbajtjen e planit të përmendur në pikën 3, të kreut II.

2. Kursi i trajnimit konsiderohet i përfunduar me sukses kur pas testimit arrihet rezultati minimumi 80% të njohurive për çdo modul. Operatori profesionist mund të ndjekë kursin e trajnimit më shumë se një herë nëse është e nevojshme.

Testimi kryhet nga një komision, i përbërë nga jo më pak se 3 specialistë të mbrojtjes së bimëve, i ngritur pranë Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (DRVMB). Rezultatet e testimit dërgohen me *email* nga DRVMB-ja.

IV. Miratimi i operatorëve profesionistë për lëshimin e pasaportave bimore

1. AKVMB-ja verifikon nëse operatorët profesionistë që kërkojnë të miratohen për lëshimin e pasaportës bimore janë në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara në kreun II.

AKVMB-ja miraton një operator profesionist për të lëshuar pasaportë bimore për familje të veçanta, klasa ose specie dhe lloje të bimëve, produkteve bimore dhe objekteve të tjera për të cilat operatori profesionist plotëson të gjitha kushtet dhe kriteret e përcaktuara në kreun II të këtij urdhri, në lidhje me shenjat e pranisë së dëmtuesve, simptomat e shkaktuara prej tyre dhe mjetet për parandalimin e pranisë dhe përhapjes së këtyre dëmtuesve.

Forma dhe përmbajtja e miratimit për lëshimin e pasaportës bimore jepet në shtojcën II bashkëlidhur këtij urdhri.

V. Pasaporta bimore për lëvizjen brenda vendit, si dhe në zonat e mbrojtura

1. Pasaporta bimore për bimët, produktet bimore dhe objektet të tjera lëshohet sipas pikës 6 të nenit 12, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar.

2. Përmbajtja e pasaportës bimore për lëvizjen brenda vendit dhe për lëvizjen brenda zonës së mbrojtur jepen respektivisht në pjesët A, B, C dhe D të shtojcës IV bashkëlidhur këtij urdhri.

VI. Inspektimi dhe heqja e miratimit

1. AKVMB-ja kryen inspektimin në vend për të konfirmuar kompetencën e operatorit profesionist të miratuar. Pajisjet, objektet dhe kapacitetet për të marrë masa janë objekt kontrolli.

2. AKVMB-ja kryen inspektim të paktën një herë në vit, dhe nëse është e nevojshme, merr mostër për testim, për të verifikuar nëse aktiviteti i operatorit profesionist të miratuar është në përputhje me dispozitat e këtij urdhri dhe legjislacionin në fuqi për pasaportën bimore.

3. AKVMB-ja merr masat e nevojshme për të siguruar që mosrespektimi i dispozitave të këtij urdhri dhe legjislacionin në fuqi për pasaportën bimore të mos vazhdojë, kur ka dijeni se një operator i miratuar nuk është në përputhje me këto dispozita ose kur një bimë, produkt bimor ose objekt tjetër, për të cilin operatori profesionist ka lëshuar një pasaportë bimore, në kundërshtim me kërkesat e mëposhtme:

a) është i pastër nga dëmtuesit karantinor ose dëmtues që konsiderohen se mund të plotësojnë kushtet për t'u përfshirë në listën e dëmtuesve karantinorë;

b) nuk është burim i futjes së një dëmtuesi jokarantinor të rregulluar ose lëvizja e tij në territorin e Republikës së Shqipërisë, nuk përhap dëmtuesin jokarantinor të rregulluar në bimët për mbjellje nëpërmjet të cilave ai transmetohet.

Përfundimisht nga shkronja “b” janë rastet e mëposhtme:

i. lëvizja e bimëve për mbjellje kryhet brenda ose ndërmjet mjediseve të operatorit profesionist në fjalë;

ii. lëvizja e bimëve të destinuara për mbjellje kryhet për dezinfektimin e tyre;

c) plotëson kërkesat për të lëvizur brenda territorit të vendit;

ç) kur është e aplikueshme, janë marrë menjëherë masat e nevojshme fitosanitare për çrrënjosjen e dëmtuesve, në rastet kur:

i. konstatohet prania e një dëmtuesi karantinor që nuk dihet të jetë në territorin e vendit;

ii. konstatohet prania e një dëmtuesi karantinor në një zonë të territorit të vendit ku nuk ka qenë më parë i pranishëm;

d) kur është e aplikueshme, lëvizjen brenda zonës së mbrojtur nëse është i pastër nga dëmtuesit karantinor të zonës përkatëse të mbrojtur.

Këto masa mund të përfshijnë edhe heqjen e miratimit për lëshimin e pasaportave bimore për bimët, produktet bimore dhe objekte të tjera.

4. Kur AKVMB-ja ka marrë masa në përputhje me pikën 3 të këtij kreu, të tjera nga heqja e miratimit për lëshimin e pasaportës bimore për bimë, produktet bimore dhe objektet e tjera, dhe kur mospërputhja me kërkesat e pikës 3 vazhdon, AKVMB-ja heq menjëherë miratimin.

5. Nëse operatori profesionist i miratuar ka zbuluar ose dyshuar për praninë e një dëmtuesi karantinor në ambientet e tij dhe nuk e ka raportuar sipas pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, AKVMB-ja pezullon ose heq miratimin për lëshimin e pasaportës bimore.

VII. Dispozita përfundimtare

1. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhri Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.

2. Ky urdhër botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi më 1 maj 2025. Përfundimisht pika 2 e kreut V, hyn në fuqi më 1 tetor 2023.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL

Frida Krifca

SHTOJCA I
MODELI KËRKESËS PËR MIRATIM PËR LËSHIMIN E PASAPORTËS BIMORE

Numri i kërkesës _____

Të dhënat e Operatori Profesionist (OP)

Emri Mbiemri	
Numri i regjistrimit të OP-së në regjistrin e OP-së	
Adresa	

Të dhënat e personit të kontaktit të emëruar nga OP-ja për të komunikuar me AKVMB-në

Emri Mbiemri	
Adresa	
Numri i telefonit	
Adresa e <i>email</i> -it	

Deklaratë e operatorit profesionist

Unë, _____, dëshiroj të aplikoj për miratim për lëshimin e pasaportës bimore për bimët, produktet bimore dhe objektet e tjera, si më poshtë:

(të përcaktohen kulturat për të cilat po aplikon)

dhe bashkëngjit konfirmimin e përfundimit me sukses të testimit të vlerësimit të kompetencës.

Unë konfirmoj se kërkesat e mëposhtme janë plotësuar dhe zbatohen në aktivitetin tim:

- pajisjet dhe objektet e nevojshme për kryerjen e ekzaminimeve dhe kapacitetet e duhura për zbatimin e masave të nevojshme për të parandaluar praninë dhe përhapjen e dëmtuesve të dëmshëm.
- plani efektiv në rast të shfaqjes së dyshimit ose zbulimit të dëmtuesve.
- sistemet e gjurmueshmërisë ose procedurat për të identifikuar lëvizjen e bimëve.

Unë pranoj që këto masa të vlerësohen nga inspektori i AKVMB-së gjatë kryerjes në vend të inspektimit.

Deklaroj si operator profesionist, që çdo ndryshim në lidhje me sa më sipër do të dorëzohet jo më vonë se 30 ditë pas datës së ndryshimit (p.sh., ndryshimi i të dhënave të personit kontaktues, kapaciteti etj.) pranë AKVMB-së.

Firma _____

Data _____

SHTOJCA II
MODELI MIRATIMIT

MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AUTORITETI KOMBËTAR I VETERINARISË DHE MBROJTJES SË BIMËVE

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____._____._____

MIRATIM NR. _____
PËR LËSHIMIN E PASAPORTËS BIMORE

Në zbatim të ligjit 105/2016, “Për mbrojtjen e bimëve”, të ndryshuar, bazuar në kërkesën nr. _____ të operatorit profesionist (emri mbiemri) me numër regjistrimi në regjistrin e operatorëve profesionist _____ dhe shkresën nr. _____, datë _____, të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, (emri rajonit) në të cilën konfirmohet se pas kryerjes së inspektimit në vend, operatori profesionist ka kompetencën e duhur për të lëshuar pasaportë bimore

MIRATOJ:

Operatorin profesionist me numër regjistrimi _____ të lëshoj pasaportë bimore për bimët, produktet bimore dhe objektet e mëposhtme:

1. _____
2. _____
3. _____
- _____
- _____
- _____

DREJTORI PËRGJITHSHËM
(emri mbiemri)
(firma, vulë)

SHTOJCA III
LLOJET DHE SPECIET E BIMËVE PËR MBJELLJE QË NUK PËRJASHTOHEN NGA
KËRKESAT E KODIT TË GJURMUESHMËRISË PËR PASAPORTAT E BIMORE

Bimët për mbjellje, të tjera nga farat, e:

- Agrumeve
- Kafes
- *Lavandula dentata* L.
- *Nerium oleander* L.
- *Olea europea* L.
- *Polygala myrtifolia* L.
- *Prunus dulcis* (Mill.) D.A. Webb
- *Solanum tuberosum* L.

SHTOJCA IV
PËRMBAJTJA E PASAPORTËS BIMORE

Elementet e pasaportës bimore, të përcaktuara në pjesët A, B, C dhe D të kësaj shtojce duhet të vendosen brenda një forme drejtkëndëshe ose katrore dhe të jenë të lexueshme pa përdorimin e një mjeti ndihmës pamor. Ato duhet të jenë brenda një vije kufizuese ose të ndara qartë nga çdo gjë tjetër e shkruar ose e ilustruar, në mënyrë që të jenë lehtësisht të dukshme dhe qartësisht të dallueshme.

PJESA A
PASAPORTA BIMORE PËR LËVIZJEN BRENDIA VENDIT

1. Pasaporta bimore për lëvizje brenda territorit të vendit përmban elementet e mëposhtme:
 - a) fjalët “Pasaportë bimore” në këndin e sipërm të djathtë të saj;
 - b) flamurin e kombëtar në këndin e sipërm të majtë të tij, të printuar me ngjyra ose bardhezi;
 - c) shkronja A, e ndjekur nga emri botanik i specieve bimore ose taksonomik, në rastin e bimëve dhe produktet bimore ose, sipas rastit, emrin e objektit përkatës, dhe opsionale, emrin e varietetit;
 - ç) shkronja B, e ndjekur më pas nga kodi me dy shkronja, të rajonit në të cilin operatori profesionist që lëshon pasaportën bimore është i regjistruar si operator profesionist, një vizë dhe numrin e regjistrimit të operatorit profesionist përkatës, i cili lëshon pasaportën bimore ose për të cilin pasaporta bimore është lëshuar nga AKVMB-ja;
 - d) shkronja C, e ndjekur nga kodi i gjurmueshmërisë së bimës, produktit bimor ose objektit tjetër në fjalë;
 - dh) shkronja Ç, kur është e aplikueshme e ndjekur nga:
 - i. emrin e vendit të origjinës (brenda ose jashtë vendit); ose
 - ii. kodin me dy shkronja të vendit të origjinës sipas shkronjës “i”.
2. Kodi i gjurmueshmërisë i përmendur në shkronjën “d” të pikës 1 mund të plotësohet, gjithashtu, me një referencë gjurmueshmërie unike, si barkode, hologram, çip ose mbajtës tjetër të dhënash, të pranishme në njësinë e tregtimit.

<p><u>PASAPORTË BIMORE</u></p> <p>A</p> <p>B</p> <p>C</p> <p>Ç</p>

PJESA B
PASAPORTA BIMORE PËR LËVIZJEN PËR NË DHE BRENDIA ZONAVE TË MBROJTUR

1. Pasaporta bimore për lëvizjen për në dhe brenda zonave të mbrojtura duhet të përmbajë këto elemente:
 - a) fjalët “Pasaportë bimore” në këndin e sipërm të djathtë të saj;
 - b) menjëherë nën këto fjalë, emrat shkencorë ose kodet e dëmtuesve karantinor të zonës së mbrojtur përkatëse;
 - c) flamurin e kombëtar në këndin e sipërm të majtë të tij, të printuar me ngjyra ose bardhezi;

ç) shkronja A, shkronja A, e ndjekur nga emri botanik i specieve bimore ose taksonomik, në rastin e bimëve dhe produktet bimore ose, sipas rastit, emrin e objektit përkatës, dhe opsionale, emrin e varietetit;

d) shkronja B, e ndjekur më pas nga kodi me dy shkronja, të rajonit në të cilin operatori profesionist që lëshon pasaportën bimore është i regjistruar si operator profesionist, një vizë dhe numrin e regjistrimit të operatorit profesionist përkatës, i cili lëshon pasaportën bimore ose për të cilin pasaporta bimore është lëshuar nga AKVMB-ja;

dh) shkronja C, e ndjekur nga kodi i gjurmueshmërisë së bimës, produktit bimor ose objektit tjetër në fjalë;

e) shkronja Ç, kur është e aplikueshme e ndjekur nga:

i. emrin e vendit të origjinës (brenda ose jashtë vendit); ose

ii. kodin me dy shkronja, të vendit të origjinës dhe, në rastin e zëvendësimit të pasaportës bimore, numri e regjistrimit të operatorit profesionist përkatës i cili ka lëshuar pasaportën bimore fillestare ose për të cilin është lëshuar pasaporta bimore fillestare nga AKVMB-ja ose autoriteti kompetent i vendit importues.

2. Kodi i gjurmueshmërisë i përmendur në shkronjën “d” të pikës 1 mund të plotësohet gjithashtu me një referencë gjurmueshmërie unike, si barkode, hologram, çip ose mbajtës tjetër të dhënash, të pranishme në njësinë e tregtimit.

PASAPORTË BIMORE

.....

A

B

C

Ç

PJESA C

PASAPORTA BIMORE PËR LËVIZJE BRENDA TERRITORIT TË VENDIT, E KOMBINUAR ME NJË ETIKETË CERTIFIKIMI

1. Pasaporta bimore për lëvizjen brenda territorit të vendit, e kombinuar në një etiketë të përbashkët me etiketën zyrtare për fara ose materiale të tjera shumëzuese dhe etiketa për materialin para-bazë, bazë ose të certifikuar, përmbajnë elementet e mëposhtme:

a) fjalët “Pasaportë bimore” në këndin e sipërm të djathtë të etiketës së përbashkët;

b) flamurin e kombëtar në këndin e sipërm të majtë të tij, të printuar me ngjyra ose bardhezi.

Pasaporta bimore duhet të vendoset në etiketën e përbashkët menjëherë sipër dhe të ketë të njëjtën gjerësi si ajo e etiketës zyrtare.

2. Pika 2 e pjesës A do të zbatohet në përputhje me rrethanat.

PASAPORTË BIMORE

.....

PJESA D

PASAPORTA BIMORE PËR LËVIZJEN PËR NË DHE BRENDA ZONAVE TË MBROJTUR, E KOMBINUAR ME NJË ETIKETË CERTIFIKIMI

1. Pasaporta bimore për lëvizje për në dhe brenda zonave të mbrojtura, e kombinuar në një etiketë të përbashkët me etiketën zyrtare për farat ose materialin tjetër shumëzues dhe etiketën për materialin parabazë, bazë ose të certifikuar do të përmbajë elementet e mëposhtme:

a) fjalët “Pasaportë bimore” në këndin e sipërm të djathtë të etiketës së përbashkët;
b) menjëherë nën këto fjalë, emrat shkencorë ose kodet e dëmtuesve karantinorë të zonës së mbrojtur të interesuar;

c) flamurin e kombëtar në këndin e sipërm të majtë të tij, të printuar me ngjyra ose bardhezi.

Pasaporta bimore duhet të vendoset në etiketën e përbashkët menjëherë sipër dhe të ketë të njëjtën gjerësi, si etiketa zyrtare ose, kur është e zbatueshme, certifikatë tjetër.

2. Pika 2 e pjesës B do të zbatohet në përputhje me rrethanat.

PASAPORTË BIMORE

.....

.....